



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 126/2013
Prishtinë, më 10.12.2013, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti- kryetar, Teuta Sahatqija, zëvendëskryetare, Sala Berisha–Shala, Shaip Muja, Lutfi Zharku, Hashim Deshishku, Myzejene Selmani dhe Etem Arifi - anëtarë.

Munguan: Fikrim Damka, Visar Ymeri dhe Ramiz Kelmendi.

Pjesëmarrës të tjerë: Ukë Gashi –ZPRK; Gani Asllani- AKK; Dardan Abazi – OJQ-INDEP dhe Amire Qamili, gazetarë – KosovaPress.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti dhe Muhamet Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Zenun Pajaziti, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 3.12.2013;
3. Shqyrtimi i Raportit me propozim-amendamente për Projektligjin nr. 04/L- 226 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës;
4. Informatë rreth pjesëmarrjes së delegacionit të Komisionit në seminarin parlamentar “Kriza ekonomike dhe ndikimi i saj në politikat e BE-së dhe vendet e zgjerimit” Bruksel, më 25-26 nëntor 2013;
5. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen sipas pikave të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 3.12.2013

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 3.12.2013, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit me propozim-amendamente për Projektligjin nr. 04/L- 226 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës

Kryetari – Grupi i punës e ka shqyrtuar Projektligjin nr. 04/L- 226 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës dhe ka nxjerrë disa amendamente. Më pas, fjalën ia dha z. Lutfi Zharku, kryesues i grupit të punës, për të paraqitur Raportin me propozim-amendamente.

Lutfi Zharku – Grupi i punës ka mbajtur dy takime, ku kanë qenë të pranishëm, përfaqësuesit e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë; përfaqësuesit e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës dhe organizatës INDEP, që po mbështesin punën e Komisionit. Po ashtu, Komisioni ka organizuar një dëgjim publik ku kanë qenë të ftuar të gjitha palët që kanë obligime ndaj ligjit, përfaqësuesit e odave ekonomike që veprojnë në Kosovë dhe të shoqërisë civile. Në fund, tha se grupi i punës ka nxjerrë njëzet e katër (24) amendamente, ku i paraqiti një nga një dhe hapi debat.

Vërejtjet në projektligj dhe amendamente

Lutfi Zharku – Te **amendamenti 4**, e kemi çështjen e hapur sa i përket “nxjerrjes së akteve nënligjore” apo më mirë të themi, mekanizmit të mbikëqyrjes me rastin e nxjerrjes, sepse ne kemi vendosur që Autoriteti t’i nxjerrë aktet nënligjore që kanë të bëjnë me përjashtimet grupore. Ai tha se e kemi një opinion nga Njësia mbështetëse e Komisionit, që mos të jetë komisioni parlamentar dhe Kuvendi ai që i miraton këto akte, sepse Kuvendi nxjerr akte ligjore, e jo nënligjore, ndërsa Komisioni nxjerr vendime vetëm për çështje të veta dhe i rekomandon Kuvendit çështjet që ka në shqyrtim.

Sala Berisha – Shala – Tha se kjo dilemë ka ekzistuar edhe në lidhje me Statutin e Autoritetit se a duhet miratuar Kuvendi apo jo, për shkak se është akt nënligjor dhe tanimë e kemi edhe këtë situatë. Ajo propozoi për të pasur një mekanizëm në lidhje me nxjerrjen e këtyre akteve nënligjore nga ana e Autoritetit.

Lutfi Zharku – Tha se kemi shembullin edhe te Ligji për lirimin nga akciza për disa mallra, ku Qeveria nxjerr vendim, pas miratimit nga Komisioni për Buxhet dhe Financa. Propozoi amendamentin 4 si në vijim:

Amendamenti 4, neni 4, paragrafi 2 i nenit të shtuar 7A, ndryshohet si vijon:

2. AKK nxjerr akt nënligjor, me të cilin përcakton kushtet për përjashtimet grupore. AKK e njofton Komisionin përkatës parlamentar, së paku pesëmbëdhjete (15) ditë para se të nxjerrë aktin nënligjor, me të cilin përcaktohen kushtet për përjashtime grupore.

Propozimi u miratua unanimisht nga Komisioni.

Lutfi Zharku – Te **amendamenti 6**, e kemi çështjen e hapur se a duhet të mbetet pozita dominuese 40% për një ndërmarrje apo 60 % për dy a me shumë ndërmarrje, apo të ndryshohet në 25%, sikurse e kanë vendet e BE-së.

Gani Asllani (Autoriteti Kosovar i Konkurrencës) – Tha se duhet të mbetet sikurse në projektligj, që pozita dominuese të jetë 40% për një ndërmarrje apo 60 % për dy a me shumë ndërmarrje, për shkak të rrethanave si vend që jemi, dhe në rajon, në të gjitha vendet është kështu dhe kapacitetet si Autoritet s'i kemi për të mbikëqyrur tregun, nëse bëhet ky ndryshim.

Dardan Abazi (OJQ- INDEP) – Si INDEP, propozojmë që të zbritet përqindja e pozitës dominuese nga 40% në 25 %, sepse kjo është e përcaktuar për vendet e BE-së dhe ne duhet të përafrojmë legjislacionin tonë me atë të BE-së.

Hashim Deshishku – Pajtohet me propozimin që përqindja e pozitës dominuese nga 40% të zbritet në 25 % dhe pozita dominuese kolektive nga 60% të zbritet në 25%.

Pas debatit, amendamenti 6 u ndryshua si vijon:

Amendamenti 6, neni 6, ndryshohet si vijon:

1. Neni 10, në paragrafin 2 të ligjit bazik dhe në tërë tekstin e ligjit bazik, ndryshohet përqindja e pozitës dominuese nga “dyzet për qind (40%)” në “njëzetë e pesë (25%) për qind”.
2. Neni 10, paragrafi 3 i ligjit bazik, riformulohet si vijon:
3. Dy ose më shumë ndërmarrje të pavarura, mund të jenë në pozitë dominuese, nëse në raport me konkurrentet e tyre veprojnë bashkërisht në tregun relevant, si dhe nëse pjesëmarrja e përgjithshme e tyre në treg është më e lartë se 40% (pozita dominuese kolektive).
3. Neni 10 të ligjit bazik, i shtohet edhe një paragrafi i ri si vijon:
4. Barra e konstatimit që pozitën dominuese në treg mund ta ketë edhe pjesëmarrësi, pjesa e të cilit në tregun relevant është më e ulët se 25%, respektivisht në raste të dominimit kolektiv më e ulët se 40%, bie mbi Autoritetin.

Lutfi Zharku – E kemi lënë të hapur çështjen statusit të administratës së Autoritetit të **amendamenti 15**, për shkak se kishim propozim nga Ministria që kjo të rregullohet me ligjin e punës, mirëpo ne e kemi kundërshtuar. Ai tha se nëpunësit e Autoritetit janë shërbyes civilë dhe i nënshtrohen Ligjit për shërbimin civil dhe shtoi se duke marrë parasysh punën e tyre të ndejshme, kemi një kërkesë nga Autoriteti që për nëpunësit të lejohet me ligj që të kenë mundësi dhe hapësirë për marrjen e formave të ndryshme të stimulimit financiar. Ai propozoi amendamentin 15 si vijon:

Amendamenti 15, neni 16, ndryshohet si vijon:

Neni 30 i ligjit bazik, riformulohet me tekstin si në vijim:

1. Organizmi, funksionimi dhe strukturimi i administratës së Autoritetit, rregullohet me Ligjin në fuqi për shërbimin civil dhe Statutin e Autoritetit.
2. Pagat dhe shtesat për nëpunësit e Autoritetit, bazohen në kushtet e veçanta nën të cilat ata i kryejnë detyrat dhe funksionet, për të cilat paguhen në përputhje me procedurat e përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

Propozimi u miratua unanimisht nga Komisioni.

Shaip Muja – Kërkoi sqarime në lidhje me **amendamentin 18**, për zgjatjen e afatit për përgjigje nga Autoriteti për palët “nga 60 ditë në 90 ditë”.

Lutfi Zharku – Tha se këtë afat e kanë të gjitha vendet e BE-së, për këtë arsye e kemi ndryshuar d.m.th për t’iu përshtatur legjislacionit të BE-së.

Kryetari – Kërkoi të dijë nga grupi i punës se me ndryshimet në projektligj, por edhe në amendamente, a janë plotësuar kërkesat që kanë dalë si rezultat i monitorimit nga ana e Komisionit tonë në vitin e kaluar.

Lutfi Zharku - Tha se janë plotësuar të gjitha, sepse kemi përmirësuar të gjitha kërkesat, si nga ana e BE-së për ndryshimin e ligjit, po ashtu edhe nga ana jonë si komision, siç janë: çështja e mandatit të Komisionit të Autoritetit dhe mënyra e zgjidhjes së tyre; forma e raportimit dhe mbikëqyrjes nga ana e Kuvendit; çështjet që kanë të bëjnë me funksionimin e administratës së Autoritetit etj. Ndërsa, në bazë të këtij ligji, duhet të ndryshohet edhe Statuti i Autoritetit dhe atëherë do të harmonizohet edhe strukturimi i brendshëm dhe kompetencat në bazë të këtij ligji.

Pas debatit, Komisioni unanimisht nxori këtë

Përfundim

1. *Miratohet Raporti me amendamente i grupit të punës për Projektligjin nr. 04/L- 226 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.*
2. *Raporti t'u procedohet Komisioneve të përhershme, sipas procedurës.*

4. Informatë rreth pjesëmarrjes së delegacionit të Komisionit në seminarin parlamentar “Kriza ekonomike dhe ndikimi i saj në politikat e BE-së dhe vendet e zgjerimit”

Kryetari – Theksoi se për këtë rend dite është hartuar një raport si informatë lidhur me pjesëmarrjen e delegacionit të Komisionit në seminarin parlamentar: “Kriza ekonomike dhe ndikimi i saj në politikat e BE-së dhe vendet e zgjerimit”. Kërkoi që të miratohet sipas proceduarve, për ta proceduar për Kryesinë e Kuvendit.

Komisioni nxori këtë

Përfundim

1. *Miratohet Informata rreth pjesëmarrjes së delegacionit të Komisionit në seminarin parlamentar “Kriza ekonomike dhe ndikimi i saj në politikat e BE-së dhe vendet e zgjerimit”.*
2. *Raporti t'i procedohet Kryesisë së Kuvendit, sipas procedurës.*

5. Të ndryshme **Çështjet vijuese**

Myzejene Selmani – Kërkoi që në Raportin për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Ndërmarrjet Publike, të shtohet edhe një rekomandim, të cilin e ka prezantuar në mbledhjen e fundit, në lidhje me përfshirjen e auditimit të jashtëm për ndërmarrjet publike. Po ashtu, kërkoi që t'i dërgohet letër znj. Edita Tahiri, zëvendëskryeministre e Qeverisë, lidhur me Marrëveshjen për energjinë elektrike, që është nënshkruar në Bruksel me palën serbe.

Shaip Muja – Sqaroi arsyet e mospërfshirjes së rekomandimit të zonjës Selmani. Ai tha se nuk ka nevojë, për shkak se ligji është i qartë në këtë aspekt dhe iu lejohej ndërmarrjeve publike që të bëjnë auditimin e jashtëm, mirëpo e kemi përfshirë tek çështja e kënaqshmërisë së publikut, tek

Rekomandimi nr. 4, ku kemi thënë: “Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike, nivelin e kënaqshmërisë së konsumatorëve, duhet të evaltojë jo nga ndërmarrja publike, por nga ndonjë mekanizëm tjetër i kontraktuar nga jashtë ndërmarrjes”.

Kryetari – Kërkoj që sipas procedurës, propozimi të bëhet në seancë plenare.

Me këtë propozim u pajtuan edhe anëtarët e Komisionit.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

E përqatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetar i Komisionit,

Zenun Pajaziti